VENDIM
Nr. 486, datë 10.7.2019

PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË STATUSIT, NGA KATEGORIA E RESURSIT "TOKË BUJQËSORE" NË "TOKË URBANE" TRUALL, PËR SIPËRFAQET QË PREKEN NGA NDËRTIMI I PROJEKTIT TË RRUGËVE PËRGJATË BREGUT JUGOR TË REZERVUARIT TË MOGLICËS, TË PASURIVE ME NUMËR 427, 770, 432/2, 429, 774, 83/5, 769, 90, 88, ZONA KADASTRALE 2937, QARKU KORÇË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 11/1, të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001, "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës", të ndryshuar, të ligjit nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", dhe të vendimit nr. 410, datë 27.6.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të ndryshimit të kategorive të resurseve të tokës", me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të statusit të tokës, nga kategoria e resursit "tokë bujqësore" në "tokë urbane", truall, për parcelat me sipërfaqe të përgjithshme 1 845 (një mijë e tetëqind e dyzet e pesë) m^2, pjesë e pasurive numër 427, 770, 432/2, 429, 774, 83/5, 769, 90, 88, zona kadastrale 2937, me vendndodhje në njësinë administrative Moglicë, Bashkia Maliq, qarku Korçë, të cilat preken nga "Projekti hidroenergjetik i Devollit, për ndërtimin e rrugëve përgjatë bregut jugor të rezervuarit të Moglicës", sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, Drejtoria e Administrimit dhe Menaxhimit të Tokës në Qarkun e Korçës të pasqyrojë në dokumentacionin kadastral përkatës ndryshimet e kategorisë së resursit nga "tokë bujqësore" në "tokë urbane", truall, respektivisht për secilën parcelë, për aq sa preket nga ndërtimi i rrugëve përgjatë bregut jugor të rezervuarit të Moglicës, parcelat me numër pasurie 427, 770, 432/2, 429, 774, 83/5, 769, 90, 88, zona kadastrale 2937, me vendndodhje në njësinë administrative Moglicë, Bashkia Maliq, qarku Korçë.
3. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Drejtoria e Administrimit dhe Menaxhimit të Tokës në Qarkun e Korçës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Lidhja 1

Nr.	VEPRA	QARKU	ZONA KADAST.	FSHATI	STATUSI PRONËS	PARCELA Nr.	PËRDORIMI	SIPËRFAQE NË KARTELË (m^2)	SIPËRFAQJA QË NDRYSHON STATUSIN (m^2)
1	Rruga Peshtan-Kodras	KORÇË	2937	PESHTAN	SHTET	427	TOKË BUJQËSORE	869	435
2	Rruga Peshtan-Kodras	KORÇË	2937	PESHTAN	SHTET	770	TOKË BUJQËSORE	2,247	265
3	Rruga Peshtan-Kodras	KORÇË	2937	PESHTAN	SHTET	432/2	TOKË BUJQËSORE	648	5
4	Rruga Peshtan-Kodras	KORÇË	2937	PESHTAN	SHTET	429	TOKË BUJQËSORE	210	8

5	Rruga Peshtan-Kodras	KORÇË	2937	PESHTAN	SHTET	774	TOKË BUJQËSORE	1585	11
6	Rruga Peshtan-Kodras	KORÇË	2937	PESHTAN	SHTET	83/5	TOKË BUJQËSORE	554	5
7	Rruga Peshtan-Kodras	KORÇË	2937	PESHTAN	SHTET	769	TOKË BUJQËSORE	2535	652
8	Rruga Peshtan-Kodras	KORÇË	2937	PESHTAN	SHTET	90	TOKË BUJQËSORE	461	282
9	Rruga Peshtan-Kodras	KORÇË	2937	PESHTAN	SHTET	88	TOKË BUJQËSORE	612	182

TOTAL (m²)	1,845.00